



Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë  
Albanian Institute of Certified Accountants

---

**S T A T U T**

**I SHOQATËS**

**INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR**



## Përmbajtje

<b>KAPITULLI I Emërtimi dhe Objekti i Veprimtarisë.....</b>	<b>5</b>
Neni 1 Emërtimi.....	5
Neni 2 Objekti i veprimtarisë.....	5
<b>KAPITULLI II Anëtarësia.....</b>	<b>9</b>
Neni 3 Anëtarësia.....	9
Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve Kontabilist të Miratuar .....	10
Neni 5 Heqja e Anëtarësisë së Kontabilistëve të Miratuar .....	11
Neni 6 Anëtari Kandidat për Kontabilist të Miratuar .....	13
<b>KAPITULLI III Asambleja e Përgjithshme.....</b>	<b>15</b>
Neni 7 Asambleja e Përgjithshme.....	15
Neni 8 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.....	19
Neni 9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme .....	21
Neni 10 Zgjedhja e Organeve Drejtuese.....	21
<b>Kapitulli IV Organet Drejtuese .....</b>	<b>25</b>
Neni 11 Këshilli i Drejtimit Objekti dhe Detyrat.....	25
Neni 12 Përbërja e Këshillit të Drejtimit .....	28
Neni 13 Mbledhjet e Këshillit të Drejtimit .....	30
Neni 14 Presidenti i IKM.....	31
Neni 15 Komiteti i Auditimit të Brendshëm Objekti.....	31
Neni 16 Përbërja .....	32
Neni 17 Komiteti i Kontrollit të Cilësisë Objekti .....	33
Neni 18 Përbërja .....	33



Neni 19 Revokimi i anëtarëve të organeve drejtuese.....	34
<b>Kapitulli V Drejtori Ekzekutiv .....</b>	<b>36</b>
Neni 20 Drejtori Ekzekutiv .....	36
<b>Kapitulli VI Organizimi i drejtimit në Rrethe .....</b>	<b>39</b>
Neni 21 Organizimi i drejtimit në Rrethe .....	39
<b>Kapitulli VII Kuotat Profesionale, Buxheti dhe Raportimi Financiar .....</b>	<b>40</b>
Neni 22 Kuotat Profesionale.....	40
Neni 23 Raportimi Financiar .....	41
Neni 24 Buxheti .....	42
Neni 25 Shpërblimet .....	43
<b>Kapitulli VIII Masat Disiplinore, Mosmarrëveshjet, Dispozita Tranzitore.....</b>	<b>44</b>
Neni 26 Masat disiplinore.....	44
Neni 27 Mosmarrëveshjet.....	44
Neni 28 Dispozita Tranzitore.....	44



Shoqata “Instituti i Kontabilistëve të Miratuar” është një organizatë profesionale e krijuar me vullnetin e lirë të profesionistëve që janë pajisur me Dëshminë “Kontabilist i Miratuar” si dhe të kandidatëve që dëshirojnë të aplikojnë për t’u pajisur me këtë Dëshmi.

Instituti i Kontabilistëve të Miratuar është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 1590, datë 18.05.2000 si një organizatë jofitimprurëse, jo qeveritare, krijuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar, e cila grupon Kontabilistët e Miratuar, Shoqëritë e Kontabilitetit dhe kandidatët për Kontabilist të Miratuar të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009, “ Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar “ i ndryshuar, me Ligjin 47/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009, i ndryshuar” si dhe çdo ligj tjetër që rregullon profesionin.



## KAPITULLI I

### Emërtimi dhe Objekti i Veprimtarisë

#### **Neni 1**

#### **Emërtimi**

1. Emërtimi i plotë i shoqatës është Instituti i Kontabilistëve të Miratuar. Emërtimi i shkurtuar është IKM. Selia e IKM ndodhet në adresën Rruga Elbasanit, Pallati Edil AL – IT, Zyra Nr. 323, Tiranë.

#### **Neni 2**

#### **Objekti i veprimtarisë**

2. Të sigurojë organizimin dhe drejtimin profesionistëve që posedojnë dëshminë "Kontabilist i Miratuar" si edhe të kandidatëve që dëshirojnë të aplikojnë për t'u pajisur me dëshminë "Kontabilist i Miratuar".
3. Të mbrojë interesat profesionale të anëtarëve të saj, duke kërkuar garancitë e duhura për kompetencat, pavarësinë dhe bindjen profesionale.
4. Të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e anëtarëve të saj ndaj palëve të treta për çështje që kanë të bëjnë me profesionin.
5. Të hartojë programet e formimit profesional në fushën e Raportimit Financiar, Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe të fushave të tjera që mund të kërkohej nga ligji apo BMP për kandidatët e saj të cilët aderojnë për t'u bërë Kontabilist të Miratuar. Të organizojë dhe monitorojë procesin e përgatitjes dhe formimit profesional të kandidatëve dhe të provimit apo testimit të njohurive të tyre



për hyrjen në profesion. Të organizojë dhe të monitorojë procesin e certifikimit të kandidatëve.

6. Të hartojë programet, të organizojë dhe monitorojë procesin e trajnimit dhe certifikimit të kandidatëve dhe anëtarëve të saj në fusha të lidhura.
7. Të sigurojë edukimin e vijueshëm të anëtarëve të saj në fushën e profesionit në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009, “ Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar“ i ndryshuar, si dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të IFAC. Të kryejë monitorimin në rastet kur këto aktivitete të Edukimit të Vijueshëm organizohen nga palë të treta të njohura nga IKM.
8. Të organizojë sistemin e Kontrollit të Cilësisë për Kontabilistët e Miratuar dhe Shoqëritë e Kontabilitetit.
9. Të organizojë sistemin e Investigimit dhe Disiplinës dhe të kryejë investigimet e nevojshme për rastet e shkeljeve të ligjeve, rregulloreve, standardeve dhe etikës profesionale, si dhe të udhëheqë sistemin e Investigimit dhe Disiplinës për aspekte të tjera brenda objektit të vet.
10. Të bashkërendojë punën me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, me Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Komisionin e Provimeve të Aftësive Profesionale, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me Universitetet me të cilat IKM ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe me organizma të tjerë të interesuara në fushën e Kontabilitetit brenda dhe jashtë Shqipërisë:
  - 10.01. Për probleme të organizmit të Kontabilitetit, të dokumentacionit kontabël;
  - 10.02. Për çështje të profesionit të parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit;



- 10.03. Për studime e punime në përmirësimin e dispozitave ligjore të kontabilitetit, standardet e kontabilitetit, standardet profesionale, rregullimet ligjore për profesionin;
- 10.04. Për organizimin përgatitjes dhe të provimeve fillestare të hyrjes në profesion dhe të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe pajisjen me Dëshminë “Kontabilist i Miratuar”;
- 10.05. Për organizimin e trajnimeve dhe certifikimin e kandidateve dhe anëtarëve me dëshmi të ngjashme, etj.;
11. Të organizojë dhe të krijojë lidhje dhe bashkëpunim me institucione e organizma homologe brenda dhe jashtë vendit.
12. Të anëtarësohet në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të profesionit dhe të udhëheqë veprimtarinë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo anëtarësi.
13. Të mbaje dhe të përditësojë Regjistrin Publik të Kontabilistëve të Miratuar dhe Shoqërive të Kontabilitetit anëtar të IKM.
14. Të mbikëqyrë anëtarët e saj për zbatimin korrekt të rregullimeve ligjore në fushën e profesionit të Kontabilistit të Miratuar, të rregullimeve dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit, auditimit legjislativ tatimor dhe standardeve profesionale me qëllim përmirësimin e Raportimit Financiar dhe rritjen cilësisë, transparencës ndaj publikut dhe besimit të publikut ndaj profesionit.
15. Të sigurojë që aktiviteti i IKM të jetë në përputhje me kërkesat e standardeve profesionale të IFAC dhe që shërbimet e ofruara nga anëtarët e IKM të jenë në përputhje me kodin e etikës së IFAC dhe aktet rregullatorë në fuqi.
16. Të sigurojë mbrojtjen e profesionit, nderit dhe pavarësisë së anëtarëve të saj.



17. Ajo mund t'u paraqesë organeve dhe autoriteteve shtetërore çdo kërkesë lidhur me profesionin që përfaqëson, si dhe paraqitet pranë këtyre organeve e autoriteteve për çështje që kanë të bëjnë me këtë profesion.
18. Të organizojë dhe zhvillojë veprimtari shkencore në shërbim të profesionit si dhe të marrë pjesë aktivitetet e organizuara në funksion te tij.
19. Të kryejë çdo detyrë tjetër që është brenda objektivit të përcaktuar në ligj dhe në këtë statut, të nevojshëm për arritjen e objektivit të IKM si organizatë profesionale e kontabilistëve





## KAPITULLI II

### Anëtarësia

#### Neni 3

#### Anëtarësia

20. Instituti i Kontabilistëve të Miratuar grupon të gjithë Kontabilistët e Miratuar, Shoqëritë e Kontabilitetit, të cilat janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në Ligjet dhe aktet rregullatorë të profesionit të Kontabilistit të Miratuar, si dhe shërbime të tjera të cilat nuk bien në kundërshtim me ligjin.
21. Anëtarë Kontabilistë të Miratuar të Shoqatës *bëhen*:
- 21.01. Profesionisti, i punësuar ose i vetëpunësuar, i cili zotëron dëshminë si “Kontabilist i Miratuar“ ose vërtetimet e provimeve të “Kontabilist i Miratuar“.
- 21.02. Shoqëria e Kontabilitetit e cila është e organizuar si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin përkatës dhe administrohet nga një ose me shumë persona të cilët janë të pajisur me dëshminë e Kontabilistit të Miratuar dhe të cilët zotërojnë jo më pak se 50 për qind të të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë.
22. Anëtarët e përmendur në paragrafin 21.01 dhe 21.02 të cilët plotësojnë kërkesat e përcaktuara për anëtarësi, pajisen me kartë anëtarësie “Kontabilist i Miratuar” e cila përmban të dhënat për individin. Kjo kartë behet e pavlefshme dhe dorëzohet në momentin e çregjistrimit nga Regjistri Publik sipas dispozitave të nenit 5 të Statutit të IKM.
23. Kërkesat specifike në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqitet për regjistrim, procedurat e anëtarësimit dhe të pajisje me Kartën “Kontabilist i Miratuar” përcaktohen në



“Rregulloren për regjistrimin dhe mbajtjen e regjistrit të anëtarëve dhe të licencave“,  
te miratuar nga Këshilli i Drejtimit.

#### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve Kontabilist të Miratuar**

24. Anëtarët e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar kanë të drejtë:
  - 24.1. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e IKM;
  - 24.2. Të informohen mbi veprimtarinë e IKM dhe administrimin e saj;
  - 24.3. Të kenë mbrojtje dhe mbështetje profesionale nga IKM;
  
25. Anëtarët e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar kanë këto detyrime:
  - 25.1. Të respektojnë kërkesat ligjore, nënligjore, statutore dhe të Rregulloreve të IKM;
  - 25.2. Të zbatojnë standardet profesionale dhe Kodin e Etikës të IFAC, si dhe Kodin e Etikës së IKM;
  - 25.3. Të shlyejë në afatet e caktuara kuotat profesionale të anëtarësisë;
  - 25.4. Të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit të Drejtimit;
  - 25.5. Të marrin pjesë në veprimtari të edukimit te vijueshëm dhe veprimtari të tjera të organizuara nga IKM;
  
26. Kanë të drejtën të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e IKM të gjithë anëtarët Kontabilistë të Miratuar të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar, të cilët ne datën e njoftimit për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, janë të regjistruar në Regjistrin Publik të IKM.
  
27. Çdo Kontabilist i Miratuar, anëtar i IKM, Person Fizik dhe Shoqëri Kontabiliteti do të dorëzojë pranë Institutit të Kontabilistëve të Miratuar, deklaratën vjetore të aktivitetit. Deklarata Vjetore do të dorëzohet fizikisht ose në format elektronik pranë IKM, jo më vonë se data 31 Janar e çdo viti. Format i Deklaratës Vjetore miratohet nga Këshilli i Drejtimit të IKM.



28. Çdo Kontabilist i Miratuar, anëtar i IKM do të dorëzojë pranë Institutit të Kontabilistëve të Miratuar, deklaratën personale të punësimit. Deklarata Personale do të dorëzohet fizikisht dhe në format elektronik pranë IKM jo më vonë se data 31 Janar e çdo viti. Format i Deklaratës Personale të Punësimit miratohet nga Këshilli i Drejtimit të IKM.
29. Për çdo ndryshim të Deklaratës personale të punësimit sipas paragrafit 28 çdo Kontabilist i Miratuar duhet të dorëzojë një Deklarate personale të punësimit të re, fizikisht dhe në format elektronik pranë IKM brenda 15 ditëve nga punësimi.
30. Anëtarët Kontabilistë të Miratuar të IKM për çdo kontratë për kryerjen e shërbimeve dhe në zbatim të saj, duhet të krijojnë një dosje të veçantë me të dhëna të plota sipas Formatit të miratuar nga Këshilli i Drejtimit. Kjo dosje do të ruhet për një afat pesëvjeçar dhe anëtari do të duhet ta paraqesë sa herë i kërkohet nga organet drejtuese.

## **Neni 5**

### **Heqja e Anëtarësisë së Kontabilistëve të Miratuar**

31. Heqja e anëtarësisë së Kontabilistëve të Miratuar nga IKM bëhet:
  - 31.1. Me kërkesë të anëtarit Kontabilist të Miratuar;
  - 31.2. Kur anëtari Kontabilist i Miratuar nuk plotëson kushtet e anëtarësisë të përcaktuara në Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar“ i ndryshuar, Statutin e Shoqatës dhe rregulloret e saj;
  - 31.3. Kryen veprime në kundërshtim me Kodin e etikës profesionale, Statutin ose dispozitat ligjore në fushën e profesionit;
  - 31.4. Si rrjedhojë e masave të marra për shkeljet e konstatuara nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës;



- 31.5. Në rast se anëtari Kontabilist i Miratuar vdes;
32. Në rast se anëtarit Kontabilist të Miratuar i hiqet anëtarësia sipas paragrafëve 31.2, 31.3 dhe 31.4, Këshilli i Drejtimit të IKM mund t'i propozojë Bordit të Mbikëqyrjes Publike marrjen e masave ndaj Kontabilistit të Miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
33. Me revokimin e anëtarësisë, Karta e Anëtarësisë bëhet e pavlefshme.
34. Shoqëria e kontabilitetit çregjistrohet nga Regjistri Publik i anëtarësisë:
- 34.1. Me kërkesën e saj të bërë nga administratori i shoqërisë;
- 34.2. Përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në Statutin e vet;
- 34.3. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri kontabiliteti hiqet si rrjedhojë e masave disiplinore të marra nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, shkeljeve të tjera ligjore në fushën e profesionit, ose si rezultat i heqjes së statusit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
35. Nuk do të pranohet kërkesa për çregjistrim në rast se anëtari Kontabilist i Miratuar nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet që lindin nga ky Statut dhe Rregulloret e IKM.
36. Nuk do të pranohet kërkesa për çregjistrim në rast se ndaj anëtarit Kontabilist të Miratuar është duke u zhvilluar procesi i kontrollit të cilësisë ose kanë nisur procedurat për investigim në përputhje me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës.
37. Procedurat për pezullimin ose tërheqjen e anëtarësisë nga IKM përcaktohen në **“Rregulloren për regjistrimin dhe mbajtjen e regjistrit të anëtarëve dhe të licencave“**, e cila miratohet nga Këshilli i Drejtimit.



## Neni 6

### Anëtari Kandidat për Kontabilist të Miratuar

38. Anëtarë të Shoqatës *bëhen* dhe Kandidatët të cilët aderojnë dhe përgatiten për të marrë titullin “Kontabilist i Miratuar“.
39. Kandidatët që aplikojnë për t’u pajisur me dëshminë “Kontabilist i Miratuar”, duhet të plotësojnë kërkesat e parashikuara në pikat ”a”, ”b” dhe ”ç”, të nenit 16 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.09, “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesve Ligjorë dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar .
40. Në kërkesën për anëtarësim përveç të tjerave deklarohet "pranimi i Statutit të IKM dhe angazhimi për zbatimin e tij".
41. Kërkesat specifike në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqitet për regjistrim, si dhe procedurat e anëtarësimit përcaktohen në **“Rregulloren për regjistrimin dhe mbajtjen e regjistrit të anëtarëve dhe të licencave“**, të miratuar nga Këshilli i Drejtimit.
42. Anëtarët Kandidatë për Kontabilist të Miratuar të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar kanë të drejtë:
  - 42.1. Të informohen mbi veprimtarinë e IKM dhe administrimin e saj;
  - 42.2. Të kenë mbrojtje dhe mbështetje profesionale nga IKM;
43. Anëtarët Kandidatë për Kontabilist të Miratuar të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar kanë këto detyrime:
  - 43.1. Të respektojnë kërkesat ligjore, nënligjore, statutore dhe të Rregulloreve të IKM;
  - 43.2. Të zbatojnë standardet profesionale dhe Kodin e Etikës të IFAC, si dhe Kodin e Etikës së IKM;
  - 43.3. Të shlyejnë në afatet e caktuara kuotat profesionale të anëtarësisë;
  - 43.4. Të zbatojnë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit të Drejtimit;



44. Kandidatët për Kontabilist të Miratuar janë anëtarë pa të drejtë vote, nuk mund të zgjedhin dhe nuk mund të zgjidhen në organet drejtuese të IKM.
45. Heqja e anëtarësisë së Kandidatëve për Kontabilist të Miratuar nga IKM bëhet:
  - 45.1. Me kërkesë të anëtarit Kandidat për Kontabilist të Miratuar;
  - 45.2. Kur anëtari Kandidat për Kontabilist i Miratuar nuk zbaton Statutin e Shoqatës dhe rregulloret e saj;
  - 45.3. Kryen veprime në kundërshtim me Kodin e etikës profesionale, Statutin ose dispozitat ligjore në fushën e profesionit;
  - 45.4. Në rast së anëtari Kandidat për Kontabilist i Miratuar vdes;
46. Anëtari kandidat për KM humbet të drejtën për të aplikuar për marrjen e Dëshmisë Kontabilist i Miratuar.
47. Nuk do të pranohet kërkesa për çregjistrim në rast se anëtari Kandidat për Kontabilist të Miratuar nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet që lindin nga ky Statut dhe Rregulloret e IKM.
48. Procedurat për pezullimin ose tërheqjen e anëtarësisë nga IKM përcaktohen në **“Rregulloren për regjistrimin dhe mbajtjen e regjistrit të anëtarëve dhe të licencave“**, e cila miratohet nga Këshilli i Drejtimit.



## KAPITULLI III

### Asambleja e Përgjithshme

#### Neni 7

#### Asambleja e Përgjithshme

49. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i IKM. Ajo përbëhet nga të gjithë personat anëtarë Kontabilist të Miratuar të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar, të cilët në datën e njoftimit për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, janë të regjistruar në Regjistrin Publik të IKM..
50. Në varësi të numrit të përgjithshëm të Kontabilistëve të Miratuar, Këshilli i Drejtimit mund të vendosë që Asambleja e Përgjithshme të përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur nga anëtarët e degëve apo seksioneve ose me të gjithë anëtarët Kontabilist të Miratuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 49 të Nenit 7.
51. Nëse Asambleja e Përgjithshme do të zhvillohet me përfaqësues të zgjedhur, atëherë do të zbatohet rregulli 1 (një) përfaqësues për çdo 4 (katër) anëtarë Kontabilistë të Miratuar që plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 49 të Nenit 7. Në rastet kur nga raporti del një numër me presje dhjetore si numër i përfaqësuesve do të jetë numri i rrumbullakosur (më shumë se 0.5 merret numri pasardhës).
52. Nëse Asambleja e Përgjithshme do të zhvillohet me përfaqësues të zgjedhur, do të organizohen mbledhjet e Degëve dhe Seksioneve ku do të jenë pjesëmarrës të gjithë ata anëtarë Kontabilistë të Miratuar, të cilët në datën e njoftimit për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme janë të regjistruar në Regjistrin Publik të IKM.
53. Mbledhjet e Degëve dhe Seksioneve do të zhvillohen brenda 15 ditëve nga njoftimi për rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme. Në këto mbledhje do të diskutohet Rendi i



Ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe do të zgjidhen përfaqësuesit për në Asamblenë e Përgjithshme.

54. Brenda 5 ditëve nga zhvillimi i mbledhjeve të Degëve dhe Seksioneve do t'i dërgohet në rrugë elektronike dhe fizikisht Stafit Ekzekutiv materialet e mbledhjeve, procedurat e votimit dhe lista e përfaqësuesve të zgjedhur.
55. Anëtarët e Këshillit të Drejtimit, Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Kontrollit të Cilësisë do të konsiderohen si përfaqësues të zgjedhur.
56. Mandati i përfaqësuesve të zgjedhur për në Asamblenë e Përgjithshme është i vlefshëm deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme pasardhëse vjetore, me të drejtë rizgjedhje.
57. Secili anëtar ka vetëm një mandat përfaqësimi, të drejtën e vetëm një vote në Asamblenë e Përgjithshme.
58. Secili anëtar mund të japë mbështetjen e tij për vetëm një anëtar që kandidon për secilën nga zgjedhjet e organeve drejtuese të IKM.
59. Çdo anëtar me të drejtë vote, voton për aq kandidatë sa është numri i vendeve vakante në zgjedhjet e organit apo organeve drejtuese, ndryshe vota do të konsiderohet e pavlefshme.
60. Asambleja e Përgjithshme:
  - 60.1. Përcakton drejtimit kryesore të zhvillimit të veprimtarisë së IKM.
  - 60.2. Ajo zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit të Drejtimit;
  - 60.3. Ajo zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm;





- 60.4. Ajo zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Cilësisë;
- 60.5. Dëgjon dhe miraton raportet Këshillit të Drejtimit, Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë;
- 60.6. Miraton propozimin e Këshillit të Drejtimit për kuotat vjetore të anëtarësisë;
- 60.7. Miraton Pasqyrat Financiare vjetore të IKM;
- 60.8. Miraton Buxhetin dhe llogaritë vjetore;
- 60.9. Miraton organigramën dhe çdo rregullim tjetër lidhur me organizimin profesional të parashikuar në këtë Statut.
- 60.10. Miraton rregulloren e Kontrollit të Cilësisë të hartuar nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë.
- 60.11. Ngarkon Këshillin e Drejtimit të miratojë rregulloret e hartuara nga komitetet e IKM sipas fushave që mbulojnë, me përjashtim të rregullores së Kontrollit të Cilësisë.
- 60.12. Vendos për bashkim me organizma të tjerë profesionale, miraton projekt marrëveshje të Këshillit të Drejtimit për anëtarësim në organizma ndërkombëtare, bashkëpunime me organizma të tjerë profesionale brenda dhe jashtë vendit etj.,
- 60.13. Vendos për blerjen e pasurive të paluajtshme të Shoqatës, me votat e jo më pak se gjysmës së anëtarëve të IKM. Vendos për shitjen e pasurive të paluajtshme të Shoqatës, me votat e jo më pak se tre të katërtat e anëtarëve të IKM.



- 60.14. Para se të deklarojë shpërndarjen vullnetare të Shoqatës, kur është rasti, vendos për mënyrën e shpërndarjes së pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme të Shoqatës.
61. Shoqata shpërndahet me iniciativën e Asamblesë së Përgjithshme.
62. Vendimi për shpërndarjen e Shoqatës merret me miratimin unanimit të të gjithë anëtarësisë Kontabilistë të Miratuar me të drejtë vote në Asamblesë të Përgjithshme.
63. Iniciativa për shpërndarjen e Shoqatës merret nga jo më pak se gjysma e anëtarësisë së IKM me të drejtë vote, e cila i paraqitet për shqyrtim Asamblesë së Përgjithshme.
64. Kërkesa me shkrim, për shpërndarjen e Shoqatës, duhet të parashtrojë shkaqet dhe arsyet që e bëjnë të pamundur vazhdimin e misionit për të cilin është krijuar Shoqata. Ajo duhet të ketë emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e secilit prej kërkuësve.
65. Asambleja e Përgjithshme vendos, me jo më pak se katër të pestat e votave të të gjithë anëtarëve Kontabilistë të Miratuar me të drejtë vote për transformimin e saj dhe jo më pak se nëntë të dhjetat e votave të të gjithë anëtarëve Kontabilistë të Miratuar me të drejtë vote për bashkimin e Shoqatës me Shoqata të tjera.
66. Asambleja e Përgjithshme vendos me votat e jo më pak se tre të katërtave të anëtarëve Kontabilistë të Miratuar me të drejtë vote në mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë për ndryshimet statutore të IKM dhe në përgjithësi vendos për çdo çështje të përcaktuar në rendin e ditës.
67. Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve vendos për çdo çështje tjetër të përfshirë në rendin e ditës brenda afateve të parashikuara nga Statuti.



## **Neni 8**

### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

68. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda nëntë mujorit të vitit, për të shqyrtuar e vendosur mbi veprimtarinë vjetore të vitit paraardhës të Këshillit të Drejtimit, të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë si dhe për Plan veprimin dhe Buxhetin e vitit pasardhës. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme behet nga Kryetari i Këshillit të Drejtimit të IKM.
69. Ajo mblidhet gjithashtu sa herë që është e nevojshme për IKM.
70. Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga:
- 70.1. Kryetari i Këshillit të Drejtimit;
  - 70.2. Kryetari i Këshillit të Drejtimit për çështje të caktuara sipas dispozitave të përcaktuara në Rregulloren e Këshillit të Drejtimit;
  - 70.3. Kryetari i Këshillit të Drejtimit kur kërkohet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të Këshillit të Drejtimit,
  - 70.4. Nga Kryetari i Këshillit të Drejtimit kur një gjë e tillë kërkohet nga të paktën 1/5 e anëtarëve me të drejtë vote;
71. Në kushtet kur kryetari i Këshillit të Drejtimit është në situatën juridike apo shëndetësore të pamundësisë për të ushtruar këtë kompetencë, Asambleja e Përgjithshme në vend të tij mund të thërritet nga zëvendësi i kryetarit, dhe në mungesë të këtij të fundit ajo thirret nga anëtari më i vjetër i Këshillit të Drejtimit.
72. Rendi i Ditës së Asamblesë së Përgjithshme, caktohet nga Këshilli i Drejtimit, i cili merr parasysh edhe propozimet ose çështjet e palëve të interesuara për thirrjen e saj në përputhje me paragrafin 74, të Nenit 8, dhe i njoftohet anëtarëve të paktën 30 dite përpara datës së mbledhjes.



73. Njoftimi i Rendit të Ditës behet nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të IKM ose nëpërmjet postës elektronike. Në njoftim përcaktohen data, ora dhe vendi ku do të zhvillohet mbledhja. Kur mbledhja thirret në rastet e parashikuara në paragrafët 105, 106, 126, 127, 134 dhe 135 afati i njoftimit i përcaktuar më sipër mund të reduktohet në 10 ditë.
74. Asambleja e Përgjithshme shqyrton vetëm çështjet e përcaktuara në rendin e ditës. Kryetari i Këshillit të Drejtimit është i detyruar të përfshijë në rendin e ditës çështjet që atij i janë paraqitur nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm për çështje të caktuara që lidhen me veprimtarinë e tij dhe në përputhje me nenin 15 të këtij Statuti, nga një e pesta e anëtarëve me të drejtë vote, dhe shumica e thjeshtë e anëtarëve të Këshillit të Drejtimit.
75. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme drejtohet nga Presidenti dhe në mungesë të tij nga Zëvendës Presidenti.
76. Sekretaria e mbledhjes së Asamblesë kryhet nga sekretaria e IKM dhe një anëtar i cili zgjidhet në fillim të mbledhjes nga asambleja me votim të hapur.
77. Në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, mbi bazën e propozimeve të hapura, zgjidhet Komisioni i Votimit, i cili përbehet nga 3 anëtarë Kontabilistë të Miratuar Aktivë, të cilët nuk mund të zgjidhen midis anëtarëve të Këshillit të Drejtimit, anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, anëtarëve të kryesive të Degëve ose Seksioneve apo kandidatëve që marrin pjesë për zgjedhjet për organet drejtuese.
78. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është e vlefshme kur në mbledhjen e parë marrin pjesë mbi 50% e anëtarëve me të drejtë vote ose të përfaqësuesve të tyre.
79. Në rast se në një mbledhje nuk sigurohet kjo pjesëmarrje, atëherë mbledhja anulohet, për t'u bërë një mbledhje e dytë, të paktën brenda 15 ditëve me të njëjtin rend dite. Në



mbledhjen e dytë vendimet merren nga anëtarët pjesëmarrës me të drejtë vote, ose përfaqësuesit, pavarësisht nga numri i tyre.

80. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të cilat merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të përfaqësuar me të drejtë vote, janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët aktivë që e ushtrojnë profesionin, anëtarët që nuk e ushtrojnë profesionin, anëtarët që janë tërhequr dhe kandidatët.
81. Votimi është i fshehtë, me përjashtim të rasteve kur në këtë Statut është parashikuar ndryshe dhe mund të realizohet edhe në mënyrë elektronike.

## **Neni 9**

### **Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme**

82. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dokumentohen me proces-verbale të mbajtura nga sekretaria e të nënshkuara edhe nga kryetari i mbledhjes.
83. Vendimet e marra nga Asambleja, përgatiten nga Sekretaria, nënshkruhen nga Sekretaria dhe Kryetari i mbledhjes dhe ju dërgohen Degëve dhe Seksioneve jo më vonë se 30 ditë pas datës së mbledhjes së Asamblesë.
84. Degët, në mbledhjen e parë të radhës njoftojnë të gjithë anëtarët për këto vendime.

## **Neni 10**

### **Zgjedhja e Organeve Drejtuese**

85. Nëse Asambleja e Përgjithshme ka në rend dite zgjedhjen e anëtarëve të organit apo organeve drejtuese të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar, Kryetari i Këshillit të



Drejtimin duhet të njoftojë anëtarët për këtë rend dite të paktën 30 ditë përpara datës së mbledhjes duke përmendur vendet vakante në organet që do të jenë objekt votimi.

86. Këshilli i Drejtimit ngre një Komision për vlerësimin e plotësimit të kriterëve të Kandidaturave të paraqitura.
87. Komisioni i vlerësimit përbehet nga 3 (tre) anëtarë të cilët janë pjesë e Regjistrin Publik të IKM dhe që nuk kandidojnë për anëtar të organeve që do zgjidhen nga asambleja.
88. Paraqitja e kandidaturës bëhet pranë sekretarisë së Institutit të Kontabilistëve të Miratuar, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Sekretaria e IKM njofton Komisionin e vlerësimit për kandidaturat e paraqitura.
89. Kërkesa për kandidim për anëtar të Këshillit të Drejtimit, shoqërohet me një mbështetje të jo më pak se 10 (dhjetë) anëtarëve Kontabilistë të Miratuar, të cilët në datën e njoftimit për Rendin e Ditës së Asamblesë së Përgjithshme janë në Regjistrin Publik të IKM dhe kanë shlyer kuotën vjetore, të cilët nënshkruajnë formularin e mbështetjes.
90. Kërkesa për kandidim për anëtar të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Kontrollit të Cilësisë, shoqërohet me një mbështetje të jo më pak se 10 (dhjetë) anëtarëve Kontabilistë të Miratuar, të cilët në datën e njoftimit për Rendin e Ditës së Asamblesë së Përgjithshme janë në Regjistrin Publik të IKM dhe kanë shlyer kuotën vjetore, të cilët nënshkruajnë formularin e mbështetjes.
91. Komisioni i Vlerësimit vlerëson plotësimin e kriterëve të kandidaturave të paraqitura. Vendimi me listën e kandidaturave që plotësojnë kriteret i paraqitet Kryetarit të Këshillit të Drejtimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
92. Kandidatëve për anëtarë të organeve drejtuese ju ndalohej çdo veprimtari publicitare, që bie në kundërshtim me Kodin e Etikës.



93. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të organeve drejtuese anëtarët e IKM të cilët:

- 93.01. Në datën e caktuar për paraqitjen e kandidaturave për anëtar të organeve drejtuese rezultojnë se nuk kanë paguar kuotat e anëtarësisë në afatin e rregullt të caktuar nga Këshilli i Drejtimit për 3 (tre) vitet e fundit;
- 93.02. Në datën e caktuar për paraqitjen e kandidaturave për anëtar të organeve drejtuese nuk janë të regjistruar në Regjistrin Publik të IKM;
- 93.03. Në datën e caktuar për paraqitjen e kandidaturave për anëtar të organeve drejtuese nuk plotësojnë 5 (pesë) vite anëtarësi në IKM si Kontabilist i Miratuar Aktiv;
- 93.04. Në datën e caktuar për paraqitjen e kandidaturave për anëtar të organeve drejtuese nuk kanë përmbushur detyrimet e Edukimit të Vijueshëm të përcaktuara në aktet rregullatorë në fuqi;
- 93.05. Brenda dy viteve të fundit janë ndëshkuar me masa disiplinore nga organet drejtuese të IKM, nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nga organet administrative ose nga organet gjyqësore;
- 93.06. Janë zgjedhur Kryetarë Dege ose Përgjegjës Seksioni në rrethet përkatës.
- 93.07. Përfshihet nga ky kufizim kryetari i degës Tiranë, i cili pasi është zgjedhur nga anëtarësia e degës Tiranë, është automatikisht anëtar i Këshillit të Drejtimit, përveçse rasteve kur ka plotësuar dy mandate radhazi në drejtimin e Degës ose si anëtar i Këshillit të Drejtimit.



- 93.08. Përfshihet nga këto rregulla, kandidati për anëtar të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë i cili vjen nga fusha akademike ose auditimit që nuk e ushtron profesionin si Kontabilist i Miratuar.
94. Vendimi i Komisionit zgjedhor për rezultatin e zgjedhjeve i paraqitet Këshillit të Drejtimit, i cili e shpall përpara mbylljes së Mbledhjes.





## Kapitulli IV

### Organet Drejtuese

#### Neni 11

#### **Këshilli i Drejtimit**

#### **Objekti dhe Detyrat**

95. Këshilli i Drejtimit siguron drejtimin e punës të IKM në periudhën midis dy Mbledhjeve të Asamblesë, bazuar në këtë Statut, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, së cilës i raporton për veprimtarinë e tij.
96. Këshilli i Drejtimit ka për detyrë:
- 96.01. Të sigurojë mbrojtjen e profesionit;
  - 96.02. Të ndjekë respektimin e rregullave të etikës profesionale në përputhje me kërkesat e Kodit të Etikës të hartuar në koherencë të plotë me kodin e Etikës të IFAC dhe bën plotësimin e tyre në qoftë se është e nevojshme;
  - 96.03. Të marrë masa parandaluese të nevojshme, për të mënjeluar çdo akt të natyrës që zhvlerëson profesionin dhe në rast nevojë vendos masa ose sanksionet e duhura në përputhje me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës pavarësisht gjyqimit civil apo penal;
  - 96.04. Të vendosë për çdo çështje, e cila lidhet ose përbën interes për profesionin e Kontabilistit të Miratuar.
  - 96.05. Të hartojë Rregulloret e funksionimit të brendshëm që ka në kompetencë sipas këtij statuti, organigramën e IKM, organigramën e Strukturës Ekzekutive dhe të Strukturave Drejtuese në rrethe.



- 96.06. Të miratojë rregulloret e hartuara nga Komitetet e ngritura pranë tij në zbatim të këtij statuti sipas detyrave që mbulojnë, përveç rregullores së Kontrollit të Cilësisë, e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme
- 96.07. Të sigurojë rregullat dhe procedurat për administrimin dhe vlerësimin e pasurisë së IKM
- 96.08. Të sigurojë funksionimin e rregullt të IKM dhe të koordinojë veprimtarinë e organeve të saj.
- 96.09. Të përzgjedhë Drejtorin Ekzekutiv;
- 96.10. Të lëshojë dëshmi ose të certifikojë kualifikimet e anëtarëve të tij, që organizon vetë ose nga të tretë;
- 96.11. Të ngrejë Komitetin e Regjistrimit si dhe të miratojë Rregulloren e regjistrimit të anëtarëve dhe kandidatëve për Kontabilist të Miratuar dhe Regjistrin Publik.
- 96.12. Të ngrejë Komitetin e Edukimit dhe Kualifikimit Profesional, të miratojë rregulloren e saj, e cila përcakton organizimin, procedurat dhe rregullat e Edukimit Profesional si dhe të monitorojë Edukimin e Vijuëshëm Profesional dhe të hyrjes në profesion.
- 96.13. Të ngrejë Komitetin e Investigimit dhe Disiplinës dhe të miratojë Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës.
- 96.14. Të organizojë, koordinojë, monitorojë dhe ndjekë veprimtarinë e Degëve dhe Seksioneve në rrethe nëpërmjet strukturës ekzekutive;
- 96.15. Të kërkojë mendim nga Këshilli i Kryetarëve të Degëve dhe Seksioneve si organ këshillues i Këshillit të Drejtimit, për çështje të parashikuara në Rregulloren e Degëve dhe Seksioneve, si dhe të marrë propozime për



përmirësimin e drejtimit të veprimtarisë së IKM, legjislacionit, profesionit, etj.

- 96.16. Këshilli i Drejtimit përfaqësohet nga një anëtar i tij në mbledhjet e Degëve dhe Seksioneve për zgjedhjen e organit drejtues, në analizat vjetore, si dhe kur kërkohet nga drejtimi i Degës ose Seksionit, ose nga shumica e anëtarëve të Degës ose Seksionit.
- 96.17. Të përgatisë e të zbatojë buxhetin e IKM dhe t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për plotësimin e buxhetit dhe për llogarite vjetore;
- 96.18. Të përfaqësojë IKM-në pranë organeve shtetërore dhe palëve të treta.
- 96.19. Të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Komisionin e Provimeve të Aftësive Profesionale, institucione dhe organizma të tjera në fushën e kontabilitetit, të legjislacionit, kualifikimit të vijueshëm profesional të anëtarëve të IKM-së, etj.,
- 96.20. Të angazhohet në organizimin e zhvillimin e provimeve të aftësive profesionale të kandidatëve për Dëshminë “Kontabilist i Miratuar“.
- 96.21. Bazuar në Statutin e IKM, dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të hartojë Programet e punës, të organizojë dhe ndjekë zbatimin e detyrave të programuara;
- 96.22. Të vendosë për krijimin e Komiteteve të punës pranë Këshillit të Drejtimit, të përcaktojë rregullimin e funksionimit të tyre dhe të ndjekë zbatimin e detyrave përkatëse.
- 96.23. Të organizojë procesin e hartimit të rregullave të kontrollit të brendshëm të funksionimit të IKM.
- 96.24. Si rregull në krye të çdo Komiteti caktohet një anëtar i Këshillit të Drejtimit.



97. Këshilli i Drejtimit mund të krijojë Komisione ose Grupe pune teknike, të cilat ai i gjykon të dobishme për të përmbushur objektivat e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar. Këshilli i Drejtimit mund të ftojë persona jo anëtarë të IKM për të marrë pjesë në Komisione ose Grupe pune.
98. Funkcionet e tjera të Këshillit të Drejtimit caktohen nga Presidenti i tij, në marrëveshje me anëtarët e Këshillit të Drejtimit.

## **Neni 12**

### **Përbërja e Këshillit të Drejtimit**

99. Këshilli i Drejtimit përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë Kontabilistë të Miratuar Aktiv dhe strukturoret si më poshtë:
- 99.01. Kryetari i Këshillit të Drejtimit, i cili është njëkohësisht dhe President i Shoqatës.
  - 99.02. Zëvendës Kryetari i Këshillit të Drejtimit, i cili është njëkohësisht dhe Zëvendës President i Shoqatës.
  - 99.03. Anëtarët, 5 (pesë) individë, përgjegjës për çështje të tjera, të ndara sipas fushës profesionale.
100. Kryetari, nënkryetari dhe Anëtarët e tjerë të Këshillit të Drejtimit mund të zgjidhen për dy mandate 4 (katër) vjeçare të njëpasnjëshme, me të drejtë rizgjedhje vetëm pas kalimit të një mandati nga përfundimi i mandatit te fundit.
101. Presidenti dhe zëvendës Presidenti zgjidhen nga anëtarët e zgjedhur të Këshillit të Drejtimit, përkatësisht anëtari me më shumë vota do të jetë Presidenti dhe anëtari me më shumë vota pas Presidentit do të zgjidhet zëvendës Presidenti.



102. Në rast votash të barabarta, zgjedhja e Presidentit dhe zëvendës presidentit do të behet me votim të hapur nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Drejtimit të zgjedhur.
103. Në rast revokimi, vdekje, dorëheqje ose çdo rasti tjetër të pengimit të anëtarëve të Këshillit të Drejtimit, Asambleja e Përgjithshme mund të kooptojë, deri në mbledhjen e asamblesë së radhës, një anëtar tjetër nga kandidatët që në zgjedhjet e mëparshme ka fituar numrin më të madh të votave, por nuk ka qenë zgjedhur si anëtar i Këshillit të Drejtimit.
104. Bazuar në sa më sipër Këshilli i Drejtimit, brenda një muaji nga data e largimit të një anëtari të Këshillit të Drejtimit, vendos caktimin provizor të kandidatit deri në datën e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
105. Numri i anëtarëve të kooptuar nuk mund të jetë më shumë se dy. Në qoftë se krijohen më shumë se dy vende vakante, atëherë Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet, për të zgjedhur aq anëtarë sa mungojnë, përfshirë edhe anëtarët e kooptuar. Anëtarët e rinj të zgjedhur përfundojnë mandatin e anëtarëve që kanë zëvendësuar.
106. Në asamblenë e ardhme të parë organizohen zgjedhjet për vendin ose vendet vakant të anëtarëve të Këshillit të Drejtimit sipas procedurave të përcaktuara në Nenin 10.
107. Këshilli i Drejtimit organizon mbledhjen e konstituimit të Këshillit të ri brenda 10 ditëve të para të muajit pasardhës pas zgjedhjes së tyre.



**Neni 13**

**Mbledhjet e Këshillit të Drejtimit**

108. Këshilli i Drejtimit si rregull mblidhet një herë në dy muaj.
109. Këshilli i Drejtimit mblidhet mbi bazën e njoftimit me shkrim të Kryetarit sa herë që e kërkojnë interesat e IKM. Në njoftim përcaktohet rendi i ditës, vendi dhe ora e mbledhjes dhe njoftimi shoqërohet me dokumentet e nevojshme.
110. Kryetari e thërret Këshillin e Drejtimit në mbledhje kur ka një kërkesë me shkrim nga të paktën tre anëtarë të tij. Në kërkesë duhet të përcaktohen çështjet për t'u përfshirë në rendin e ditës.
111. Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga Kryetari ose në mungesë të tij, nga Zëvendës Kryetari. Në mungesë të të dyve mbledhja e Këshillit të Drejtimit mund të kryesohet nga anëtari më i vjetër i Këshillit i pranishëm.
112. Këshilli i Drejtimit mund të marrë vendime kur janë të pranishëm jo më pak se  $\frac{2}{3}$  e anëtarëve. Mbledhja e Këshillit të Drejtimit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 5 anëtarë.
113. Vendimet merren me shumicë absolute votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vota e Kryetarit, ose në mungesë të tij, e zëvendës Kryetarit, është përcaktuese.
114. Vendimet e Këshillit të Drejtimit reflektohen në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit të Drejtimit dhe personi i ngarkuar për mbajtjen e procesverbalit.
115. Anëtarët e Këshillit të Drejtimit, pjesëmarrës në mbledhje, firmosin listë prezencën e cila i bashkëngjitet procesverbalit të mbledhjes.



#### **Neni 14**

##### **Presidenti i IKM**

116. Presidenti është përfaqësuesi ligjor i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar. Ai përfaqëson Institutin në marrëdhëniet me të tretët. Të gjitha dokumentet që dalin nga IKM duhet të jenë të nënshkruara nga Presidenti, ose në mungesë të tij, nga Zëvendës Presidenti.
117. Presidenti dhe në mungesë të tij, Zëvendës Presidenti, mund të autorizojnë anëtarë të IKM për lidhje kontratash me të tretë ose për të përfaqësuar IKM në marrëdhënie me Institucione ose organizma të tjera.

#### **Neni 15**

##### **Komiteti i Auditimit të Brendshëm**

##### **Objekti**

118. Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka për detyrë të verifikojë, kontrollojë veprimtarinë financiare të IKM, të mbikëqyrë zbatimin e procedurave kontabël, të kontrollojë pajtueshmërinë e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike me buxhetin si dhe rregullsinë dhe korrektësinë e pasqyrave financiare vjetore të IKM.
119. I jep mendim Këshillit të Drejtimit për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit.
120. Për verifikimet e kryera dhe rezultatet e nxjerra prej tyre, Komiteti i Auditimit të Brendshëm i paraqet raport Asamblesë së Përgjithshme të IKM. Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm nënshkruajnë bashkërisht raportin. Ne rast mosmarrëveshjes, secili prej anëtarëve paraqet veçmas mendimet dhe vlerësimet në Asamblenë e Përgjithshme, e cila vendos përfundimisht.
121. Komiteti i Auditimit të Brendshëm mblidhet të paktën një herë në vit, për të shqyrtuar llogaritë vjetore e për të përgatitur raportin lidhur me to, si dhe sa herë që gjykon të



nevojshme vetë, apo në raste kur kërkohet nga Këshilli i Drejtimit për çështje të veçanta që ka në objekt ai sipas këtij statuti.

## **Neni 16**

### **Përbërja**

122. Komiteti i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga tre anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, për një periudhe katër vjeçare. Ata mund të rizgjidhen, por jo më shumë se një herë.
123. Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, bëhet me votim të fshehtë, kundrejt paraqitjes individuale të kandidaturës.
124. Paraqitja e kandidaturave dhe zgjedhja e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Nenin 10 të këtij Statuti.
125. Kryetar i Komitetit caktohet kandidati që fiton numrin më të madh të votave. Në rast votash të barabarta, kryetar caktohet kandidati më i moshuar.
126. Shkarkimi i anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm bëhet nga mbledhja më afërt e ardhshme e Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin në rendin e ditës shkarkimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm.
127. Në asamblenë e ardhme të parë organizohen zgjedhjet për vendin ose vendet vakant të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm sipas procedurave të përcaktuara në Nenin 10.





### **Neni 17**

#### **Komiteti i Kontrollit të Cilësisë**

##### **Objekti**

128. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë ka për detyrë të verifikojë dhe kontrollojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Kontabilistët e Miratuar, në përputhje me Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar“ i ndryshuar, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit, legjisllacionin tatimor, rregullat e tjera që lidhen me profesionin si dhe Kodin e Etikës profesionale.
129. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë vepron në bazë të Rregullores të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqatës.

### **Neni 18**

#### **Përbërja**

130. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, dy prej të cilëve janë anëtar të shoqatës, Kontabilistë të Miratuar Aktivë dhe një anëtar zgjidhet nga fusha akademike ose mund të jetë profesionist kontabiliteti apo auditimi që nuk e ushtron profesionin.
131. Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë, bëhet me votim të fshehtë, nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 2 vjeçare, por jo më shumë se dy mandate, kundrejt paraqitjes individuale të kandidaturës
132. Paraqitja e kandidaturave dhe zgjedhja e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Nenin 10 të këtij Statuti.
133. Kryetar i Komitetit caktohet kandidati, anëtar aktiv i IKM, që fiton numrin më të madh të votave. Në rast votash të barabarta, kryetar caktohet kandidati më i moshuar.



134. Shkarkimi i anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë behet nga mbledhja më afërt e ardhshme e Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin në rendin e ditës shkarkimin e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë.
135. Në asamblenë e ardhme të parë organizohen zgjedhjet për vendin ose vendet vakant të anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë sipas procedurave të përcaktuara në Nenin 10.

### **Neni 19**

#### **Revokimi i anëtarëve të organeve drejtuese**

136. Funkcionet e Anëtarit të organeve drejtuese përfundojnë kur:
  - 136.1. Anëtarit i mbaron mandati;
  - 136.2. Shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur veprimet ose mos veprimet e tyre, bien ndesh me Statutin, Ligjin dhe Rregulloret e IKM;
  - 136.3. Shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur veprimet ose mos veprimet e tyre cenojnë rendë reputacionin e Kontabilistit të Miratuar dhe të IKM.
  - 136.4. Shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur nuk marrin pjesë dy mbledhje të njëpasnjëshme.
  - 136.5. Humbasin automatikisht cilësinë e tyre si anëtar në rastet kur ndëshkohen me masa disiplinore, ndëshkohen me vendim gjykate ose u hiqet apo pezullohet e drejta e ushtrimit të profesionit si Kontabilist i Miratuar nga BMP apo gjykata.
  - 136.6. Humbasin automatikisht cilësinë e tyre si anëtar në rastet kur nuk janë pjesë e Regjistrisë Publikë të IKM.
  - 136.7. Jep dorëheqjen ose vdes.



137. Shkarkimi i një anëtari të organeve drejtuese kërkohet nga Kryetari i Këshillit të Drejtimit dhe në mungesë të tij nga nënkryetari, kërkesë e cila i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme sipas dispozitave të Nenit 8, paragrafit 72 dhe 74 të këtij Statuti.
  
138. Pas përfundimit të mandatit, një anëtar i organeve drejtuese ushtron funksionet e tij deri në datën e zgjedhjeve të anëtarëve të rinj të organeve drejtuese.

## Kapitulli V

### Drejtori Ekzekutiv

#### Neni 20

#### Drejtori Ekzekutiv

139. Drejtori Ekzekutiv propozohet nga Presidenti i Shoqatës, nga çdo anëtar i Këshillit të Drejtimit dhe përzgjidhet ndërmjet kandidaturave të paraqitura nga Këshilli i Drejtimit. Kriteret që duhet të plotësojë kandidatura për Drejtor Ekzekutiv dhe procedura e përzgjedhjes së tij përcaktohet nga Këshilli i Drejtimit.
140. Individët që paraqesin kandidaturën e tyre për postin e Drejtorit Ekzekutiv të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar duhet të plotësojnë këto kriteret:
- 140.1. Të jenë Kontabilistë të Miratuar Aktiv, pjesë e Regjistrimit Publik të IKM;
  - 140.2. Të kenë figure të pastër morale;
  - 140.3. Të kenë njohuri në fushën e administrimit të njësive ekonomike jo fitimprurëse;
  - 140.4. Të kenë diplome të shkollës së lartë në një nga drejtimit e ekonomisë, kontabilitetit ose jurisprudencës;
  - 140.5. Të kenë eksperience punë në drejtim jo më pak se 7 vjet;
  - 140.6. Këshilli i Drejtimit mund të përcaktojë kriteret e tjera shtesë që lidhen me natyrën e fushës profesionale.
141. Procedurat e detajuara të përzgjedhjes përcaktohen nga Këshilli i Drejtimit.
142. Presidenti i Shoqatës emëron njërin prej tre kandidaturave të mara. Për të bërë përzgjedhjen e drejtorit ekzekutiv duhet të paktën të jenë 2 kandidatura.



143. Drejtori Ekzekutiv kryen administrimin ekonomik, financiar dhe veprimtarinë e përgjithshme ekzekutive, nëpërmjet strukturës ekzekutive të Shoqatës.
144. Me autorizim të Kryetarit të Këshillit të Drejtimit, Drejtori Ekzekutiv përfaqëson IKM në veprimtaritë që kanë të bëjnë me çështje të administrimit, zhvillimit profesional dhe institucional.
145. Drejtori Ekzekutiv, me kërkesë të Kryetarit të Këshillit të Drejtimit, kryen detyra të cilat lidhen me veprimtarinë dhe forcimin institucional të IKM.
146. Ky administrim kryhet në përputhje me kompetencat dhe funksionet e përcaktuara në Rregulloren e Strukturës Ekzekutive, e cila miratohet nga Këshilli i Drejtimit.
147. Rregullorja e Strukturës Ekzekutive, përcakton, por jo ekskluzivisht, si më poshtë:
  - 147.01. Mënyrën e funksionimit dhe përgatitjes, nga pikëpamja administrative, të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, të Këshillit të Drejtimit, dhe të mbledhjeve të Këshillit të Kryetarëve të Degëve dhe Seksioneve;
  - 147.02. Organizimin e sekretarisë së Asamblesë së Përgjithshme;
  - 147.03. Organizimin dhe zhvillimin e kurseve të kualifikimit;
  - 147.04. Mbajtjen e arkës, të librave kontabël dhe të regjistrimeve në këto libra, të evidencës kontabël dhe përgatit Pasqyrat Financiare periodike dhe vjetore;
  - 147.05. Ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të IKM dhe ja paraqet rregullat e Kontrollit të Brendshëm të IKM Këshillit të Drejtimit për miratim;
  - 147.06. Kryerjen e pagesave sipas kompetencave;



- 147.07. Ndjekjen e veprimtarisë së Degëve dhe Seksioneve;
- 147.08. Zbatimin e Programeve dhe Vendimeve të Këshillit të Drejtimit;
- 147.09. Përbërjen dhe Organizimin e strukturës ekzekutive dhe të emërimeve të stafit ekzekutiv, të cilat miratohen nga Këshilli i Drejtimit.
148. Këshilli i Drejtimit shkarkon Drejtorin Ekzekutiv në këto raste:
- 148.1. Kur me veprimet ose mosveprimet e tij janë dëmtuar rëndë reputacioni i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar dhe të profesionit të Kontabilistit të Miratuar;
- 148.2. Kur ka shkelje të rënda të dispozitave të këtij statuti dhe të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme apo Këshillit të Drejtimit, të cilat dëmtojnë ndjeshëm reputacionin e IKM dhe pengojnë arritjen e objektivave të tij.
149. Në rast të shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 148, të Nenit 20, të këtij statuti si dhe në rast vdekje ose dorëheqje të tij, Kryetari i Këshillit të Drejtimit mund të komandojë në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv një individ tjetër, i cili përmbush kriteret e parashikuara në paragrafin 140, të Nenit 20 të këtij Statuti.
150. Drejtori Ekzekutiv i Komanduar i paraqitet për miratim Këshillit të Drejtimit, nga Kryetari i Këshillit të Drejtimit jo më vonë se në mbledhjen e cila duhet të thirret brenda 2 muajve nga data e komandimit të Drejtorit Ekzekutiv.



## Kapitulli VI

### Organizimi i drejtimit në Rrethe

#### Neni 21

#### **Organizimi i drejtimit në Rrethe**

151. Bazuar në numrin e anëtarëve të çdo rrethi, Këshilli i Drejtimit vendos krijimin e Degëve ose të Seksioneve përkatësisht.
152. Seksionet krijohen në rrethe që kanë deri në 20 anëtarë. Disa Seksione në afërsi me njëri tjetrin mund të kërkojnë krijimin e Degës duke u bashkuar.
153. Rregullorja funksionimit të organeve drejtuese të Degëve dhe Seksioneve hartohet dhe miratohet nga Këshilli i Drejtimit të IKM.
154. Organet drejtuese të Degëve e Seksioneve zgjidhen me një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë, nga anëtarët e Degës ose Seksionit me votim të fshehtë.
155. Rregullat e zgjedhjes së kryesive të Degëve dhe Seksioneve, si dhe forma e votimit përcaktohen në Rregulloren e funksionimit të Degëve dhe Seksioneve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.



## Kapitulli VII

### Kuotat Profesionale, Buxheti dhe Raportimi Financiar

#### Neni 22

#### **Kuotat Profesionale**

156. Kuotat e detyrueshme vjetore të anëtarësisë përbëhen nga një kuotë fikse, e cila paguhet nga Anëtarët e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar si më poshtë:

156.1. Anëtarët Kontabilistë të Miratuar të punësuar dhe anëtarët Kontabilistë të Miratuar që nuk e ushtrojnë profesionin paguajnë një shumë fikse, e cila nuk mund të jetë më pak se 5,000 lekë;

156.2. Anëtarët Kontabilistë të Miratuar të vetëpunësuar dhe anëtarët Kontabilistë të Miratuar që e ushtrojnë profesionin si Shoqëri Kontabiliteti, ku janë njëkohësisht Ortak i vetëm dhe Administrator të saj paguajnë një shumë fikse, e cila nuk mund të jetë më pak se 10,000 lekë;

156.3. Anëtarët Kontabilistë të Miratuar që e ushtrojnë profesionin si Shoqëri Kontabiliteti, ku janë dy ose më shumë ortakë, paguajnë një shumë fikse, e cila nuk mund të jetë më pak 20,000 lekë. Për çdo ortak shtesë do të paguhet një shumë fikse, e cila nuk mund të jetë më pak se 10'000 lekë.

156.4. Anëtarët Kontabilistë të Miratuar që e ushtrojnë profesionin si Shoqëri Kontabiliteti, ku një shoqëri tjetër është ortak ose aksionar, paguajnë një shumë fikse, e cila nuk mund të jetë më pak se 40,000 lekë.

156.5. Anëtarët Kontabilistë të Miratuar, te cilët nuk janë pjesë e Regjistrimit Publik, por vazhdojnë të jenë anëtarë të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar paguajnë një





shumë fikse sipas mënyrës së ushtrimit të profesionit dhe vlerave të përcaktuara në paragrafët 156.1 dhe 156.2 të këtij neni.

156.6. Anëtarët kandidatë për Kontabilist të Miratuar, paguajnë një shumë fikse, e cila nuk mund të jetë më pak se 2,000 lekë.

157. Asambleja e Përgjithshme miraton çdo vit shumën e kuotës fikse, me propozim nga Këshilli i Drejtimit.
158. Këshilli i Drejtimit cakton afatin dhe mënyrat e mbledhjes së kuotave në përputhje edhe me kërkesat në fuqi nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
159. Në rast të mospagimit të kuotës për një periudhë prej më shumë se 9 muaj nga data e caktuar, Këshilli i Drejtimit i propozon Bordit të Mbikëqyrjes Publike pezullimin e Kontabilistit të Miratuar dhe heqjen e tij nga Regjistri Publik.
160. Anëtarët e IKM që largohen, janë të detyruar të paguajnë kuotën në varësi të muajit të largimit.
161. Për vitin e parë të regjistrimit anëtarët e rinj, paguajnë Kuotën fikse e cila paguhet në përpjesëtim me periudhën e mbetur deri në fund të vitit.

### **Neni 23**

#### **Raportimi Financiar**

162. Brenda muajit Mars të çdo viti, Struktura Ekzekutive, i paraqet Këshillit të Drejtimit:
- 162.1. Pasqyrat vjetore për vitin e mbyllur;
- 162.2. Projekt buxhetin për vitin e ri;



163. Këshilli i Drejtimit vendos për pasqyrat vjetore që do t'i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme, të cilat duhet të japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin e mbyllur.
164. Të paktën dy muaj para datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, pasqyrat vjetore i jepen për verifikim Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili duhet të depozitojë raportin një muaj para datës së mbledhjes.
165. Pasqyrat e vjetore, raporti i Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Projekt-Buxheti i bashkëlidhen vendimit të Asamblesë së Përgjithshme që i ka shqyrtuar dhe miratuar ato.
166. Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur do të auditohen nga Auditues Ligjor të caktuar nga Këshilli i Drejtimit.

#### **Neni 24**

#### **Buxheti**

167. Votimi i buxhetit bëhet për tërësinë e tij duke caktuar edhe kuotat përkatëse për shumat e marra në konsideratë për hartimin e buxhetit të të ardhurave.
168. Këshilli i Drejtimit është i autorizuar të mbledhë të ardhurat e të kryeje shpenzime edhe gjatë gjashtë muajve të parë të ushtrimit vijues, në kufijtë e buxhetit për të ardhurat e shpenzimet e miratuara për një periudhë raportuese.
169. Teprica e të ardhurave mbi shpenzimet e çdo viti mbartet në vitin pasardhës ose mund të kalojë në rezervën e përgjithshme apo në një rezervë speciale, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast se në ndonjë ushtrim shpenzimet rezultojnë më të mëdha se të ardhurat, teprica kalon në pakësim të rezervave ose mbartet për ushtrimin e ardhshëm, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



170. Rregullat për hartimin e buxhetit përcaktohen në Rregulloren e Këshillit të Drejtimit.

### **Neni 25**

#### **Shpërblimet**

171. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme anëtarëve të Këshillit të Drejtimit, anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë ju caktohet një shpërblim fiks për pjesëmarrje në veprimtari të secilit.
172. Pagesat për komitetet e krijuara nga Këshilli i Drejtimit, për anëtarët e Komiteteve si dhe për stafin ekzekutiv, caktohen nga Këshilli i Drejtimit.

## Kapitulli VIII

### Masat Disiplinore, Mosmarrëveshjet, Dispozita Tranzitore

#### **Neni 26**

#### **Masat disiplinore**

173. Për shkeljen e rregullave të profesionit “Kontabilist i Miratuar”, dispozitave ligjore, Kodit të Etikës profesionale, si dhe të këtij Statuti dhe Rregulloreve të IKM, Këshilli i Drejtimit vendos për masat disiplinore bazuar në propozimet e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës.
174. Procedurat e shqyrtimit të shkeljeve dhe vendosjes së masave disiplinore përcaktohen në Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës.

#### **Neni 27**

#### **Mosmarrëveshjet**

175. Mosmarrëveshjet të cilat mund të lindin ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe Asamblesë se Përgjithshme, Këshillit të Drejtimit dhe/ose Drejtorit Ekzekutiv ose ndërmjet organeve drejtuese të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët kanë të drejtë t’i drejtohen gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Neni 28**

#### **Dispozita Tranzitore**

176. Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar.



177. Brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij Statuti, me qëllim vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për të qenë anëtar i organeve drejtuese, Këshilli i Drejtimit krijon një komision të posaçëm “ad-hoc”, të përberë nga tre anëtarë, të cilët nuk duhet të jenë anëtarë të Këshillit të Drejtimit apo të organeve të tjera drejtuese të IKM-së.
178. Ky komision do të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të anëtarëve të zgjedhur në Organet Drejtuese, të cilat do të riorganizohen, aty ku është nevoja, në përputhje me kërkesat e këtij Statuti.
179. Me miratimin e këtij Statuti, mandatet aktuale të anëtarëve të zgjedhur në organet drejtuese do të konsiderohen si mandati i tyre i parë aktiv.
180. Për sa nuk është trajtuar në këtë Statut zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi, në veçanti Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009 ‘Për auditimin ligjor, organizmin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar’ i ndryshuar me Ligjin Nr. 47/2016 dhe Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar.

Ky Statut u redaktua në pesë ekzemplare origjinalë, duke pasur secili fuqi të barabartë ligjore, nga të cilët një ekzemplar depozitohet në Zyrën e Noterisë Tirane, një ekzemplar depozitohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe tri ekzemplare depozitohen në selinë e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar.

Miratuar në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme;

**30 Shtator 2022**

**Asambleja e Përgjithshme**  
**Presidenti i Shoqatës**  
**Sotiraq Dhamo**